

**RAPORT PERIODIK MBI MONITORIMIN E TREGUT TË ENERGJISË DHE
AKTIVITETIN E TË LICENCUARVE NË SEKTORIN E ENERGJISË ELEKTRIKE
PËR 6-MUJORIN E PARË TË VITIT 2024.**

Bazuar në ligjin nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar, objektivat dhe përgjegjësitë e ERE-s, ndër të tjera lidhen me, monitorimin e tregut të energjisë dhe aktivitetin e të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike. Specifikisht në nenin 20, gërma ç) parashikohet se, ERE monitoron dhe kontrollon funksionimin e tregut të energjisë elektrike dhe detyron të licencuarit të ndërmarrin masa të nevojshme për nxitjen e konkurrencës efektive dhe sigurinë e funksionimit të tregut.

Në mënyrë që të sigurohen raportime sa më korrekte dhe në kohë nga të licencuarit dhe pjesëmarrësit e tregut të energjisë elektrike, me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 203, datë 12.12.2019, u miratuan “Rregullat për monitorimin e tregut të energjisë elektrike”. Në këto rregulla janë përcaktuar procedurat dhe formatet e raportimit dhe dërgimit të informacionit dhe të dhënave në ERE nga pjesëmarrësit e tregut të energjisë dhe të licencuarit.

ERE është në proces të zhvillimit të një platforme elektronike e cila do t’i mundësojë pjesëmarrësve në tregun e energjisë të plotësojnë të gjitha detyrimet që rrjedhin nga Direktivat dhe Rregulloret e KE-së si dhe ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar dhe ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror” i ndryshuar. Kjo platformë njëkohësisht do t’i shërbejë të gjithë të interesuarve për marrjen e informacioneve dhe të dhënave të nevojshme në një kohë sa më të shpejtë. Gjithashtu kjo platformë synon të kontribuojë pozitivisht edhe në vijimin dhe përmirësimin e praktikave të publikimit të të dhënave nga ERE në zbatim të nenit 19, gërma k) dhe ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar.

Pavarësisht sa më sipër, ERE mban nën vëzhgim të vazhdueshmë të gjithë pjesëmarrësit e tregut të energjisë e elektrike, e vecanërisht të licencuarit të cilët si rrjedhojë e ushtrimit të aktivitetit të rregulluar kanë detyrimin jo vetëm ti përmbahen legjislacionit të sektorit në tërësi por edhe një sërë rregullave operationale të miratuara nga ERE, me qëllim jo vetëm kryerjen e shërbimit të licencuar por edhe raportimit periodik sa i përket performancës së tyre në kryerjen e sa më sipër.

Nga analizimi i rezultateve dhe përpunimi i problematikave e informacioneve të marra nga ERE, është gjykuar sipas rastit të zhvillohen verifikime, analiza, seanca dëgjimore dhe monitorime.

Për më tepër është analizuar situata e raportimeve periodike të të licencuarve ku konstatohen vonesa apo mos dërgim në kohë nga ana e tyre në respektim të detyrimit për raportim periodik brenda afateve të përcaktuara nga subjektet, lidhur me sa konstatuar ERE ka vijuar me korrespondencat përkatëse në kuadër të përmirësimit të këtyre praktikave.

Përfaqësues të ERE-s janë anëtarë të grupeve të punës së organizmave ndërkombëtare me të cilat ERE ka vendosur dhe ruan marrëdhënie të ngushta bashkëpunimi. Në këtë kuadër ERE e dërgon informacionin e siguruar nga raportimet periodike në institucionet e organizatat e ndryshme bashkëpunuese me të, si dhe merr pjesë në takime, që janë në objektin e punës së saj. Këto të dhëna të monitoruara dhe të analizuara shërbejnë gjithashtu si kontribut në praktikën e këtyre institucioneve si dhe në plotësimin e pyetësorëve dhe korrespondencave.

Në mënyrë që të rritet transparenca në tregun e energjisë elektrike, ERE ka vijuar të monitorojë zbatimin e vendimit të bordit të ERE-s nr. 118, datë 27.07.2017, i cili ka miratuar “Rregullat për publikimin e të dhënave bazë të tregut të energjisë elektrike” duke mbajtur edhe korrespondencat përkatëse me operatorët përgjegjës.

Të dhënat kryesore (4) katër mujore dhe më frekvente për funksionimin e tregut të energjisë elektrike kanë vijuar të publikohen dhe për këtë periudhë të vitit 2024 rregullisht në faqen e internetit të EREs, sipas parashikimeve të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar. Këto të dhëna japin informacione dhe raporte të detajuara lidhur me prodhimin, transmetimin, shpërndarjen dhe furnizimin e energjisë elektrike dhe tregun e energjisë elektrike në vendin tonë.

Për të siguruar zbatimin e parashikimeve ligjore dhe nënligjore të detyrimeve që lidhen me transparencën në tregun e energjisë, ERE ka monitoruar periodikisht faqet e internetit të operatorëve kryesorë në tregun e energjisë. Rezulton se edhe për gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2024 këto detyrime zbatohen kryesisht nga operatorët në kuadër të rritjes së transparencës dhe për çdo rast nga ana e ERE-s janë vijuar komunikimet, me anë të të cilave ERE i vendos përpara përgjegjësisë dhe i rikujton operatorëve detyrimin konstant që kanë për përmirësimin e këtij procesi duke i evidentuar detyrimet që duhet të përmbushin në zbatim të akteve përkatëse.

Nga ana e operatorëve është vënë re përmirësimi i informacionit dhe të dhënave që publikohet në kuadër të transparencës, kryesisht OST sh.a., në faqen e saj të internetit dhe nëpërmjet platformës së transparencës së ENTSO-E, kjo për faktin se OST sh.a. është anëtare e ENTISOE dhe ka detyrimin e publikimit të informacionit dhe në platformën e transparencës të kësaj organizate. Gjithësesi, përmirësimet të këtij procesi duhet të vijojnë dhe do të jenë objekt i punës së ERE-s në vijimësi, kjo theksuar edhe më herët nëpërmjet komunikimeve me Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë dhe OST sh.a.

ERE, me qëllim monitorimin dhe grumbullimin e të dhënave të cilat japin një pasqyrë të plotë të funksionimit dhe zhvillimeve të tregut të energjisë elektrike, ushtron këtë detyrë nëpërmjet mbledhjes së të dhënave e marrjes së informacionit dhe të dhënave nëpërmjet raportimeve periodike nga të licencuarit dhe monitorimit në vijimësi duke kryer verifikimet e këtyre të dhënave të së njëjtës natyrë të marra nga burime të ndryshme raportimi si dhe nëpërmjet monitorimeve specifike të kryera pranë të licencuarve me objekte të ndryshme monitorimi.

Sa i përket periudhës përgjatë 6-mujorit të parë të vitit 2024, konstatojmë dhe raportojmë rezultate të analizuara sipas nënkategorive në vijim të këtij raporti, për të cilat raporte të dhënash më të detajuara gjenden në anekset përkatëse të po këtij raporti.

• **Bilanci elektro-energjitik i 6-mujorit të parë 2024**

Për mbulimin e nevojave të konsumit të vendit, për këtë periudhë rezulton se Prodhimi publik ka qene 2,122,660 MWh ose rreth 49 % e prodhimit total vendas (4,318,777 MWh).

Nga Prodhuesit me përparësi rezulton se sasia e energjisë së prodhuar ka arritur në masën e 1,410,469 MWh duke zënë kështu 32 % të prodhimit vendas dhe nga Prodhuesit e pavarur rezulton se sasia e energjisë së prodhuar ka arritur në masën e 785,648 MWh duke zënë kështu 18 % të prodhimit vendas.

Konsumi në Treg të rregulluar ka qene 3,364,165 MWh ose 60 % e konsumit vendas (3,997,093 MWh) kurse Konsumi në treg të Lirë ka qene 1,620,812 MWh ose 40 % e konsumit vendas.

Ballanca në interkoneksion (hyrje/dalje) ka qënë 1,089,087 MWh në dhenie favorizuar nga prodhimi i lartë vendas në kushtet e një situate të mirë hidrike.

Në tabelën e mëposhtme paraqiten vlerat e 6-mujorit të parë të 2024 krahasuar me të njëjtën periudhë të 2023:

Prodhimi Vendas-Konsumi-Ballanca interkoneksion (MWh)		
Krahasimi 6-mujorëve 2023,2024		
	6-mujori 2023	6-mujori 2024
Prodhimi Vendas	5,056,182	4,318,777
Ballanca në Interkoneksion <i>dhenie(-)/marrje(+)</i>	(1,089,087)	(321,681)
Konsumi	3,967,095	3,997,096


Me poshtë paraqitet situata e tregut të energjisë elektrike grafikiisht ne mënyre më te detajuar.

TË DHËNA TË TREGUT TË ENERGJISË ELEKTRIKE PËR 6-Mujorin VITI 2024 NË RAPORT ME ENERGJINË E KONSUMUAR NË SHQIPËRI																								
Prodhimi Vendas					4,318,777					MWh		321,681	MWh	Konsumi Vendas			3,997,093		MWh					
PRODHIMI NË TREG TË RREGULLUAR					PRODHIMI NË TREG TË LIRË							BALLANCA	Hyrje(+), Dalje (-)	KONSUMI NË TREG TË RREGULLUAR			KONSUMI NË TREG TË LIRË							
69.9%					14.8%							7.4%		67.1%			33.6%							
Prodhimi	Prodhuës me Përparesi				PRODHUES TË PAVARUR							BALLANCA		KONSUMI NË TREG TË RREGULLUAR			KONSUMI NË TREG TË LIRË							
Publik																								
42.0%	27.9%				14.8%							7.4%		67.1%			33.6%							
KESH sha		HC.Priv/Kon ne Rrjetin e OSHEE									Dalje nga Interkoneksioni			Familjarë										
10,458		HC.Priv/Kon ne Rrjetin e OST												Jofamiliarë										
591,893		FOTOVOLTAIK												FMF (Jofamiliarë)										
652,685		HEC Ashta												shitur si dëm ekonomik										
33,805		H/C Banja												Kons.TL										
121,628		H/C Moglica												Kons. 35kv në treg të lirë										
108,386		H/C KURUM												Kons nga Kliente te F.TL ne treg të lirë										
208,656		H/C Peshqesh												Humbje OST										
212,543		H/C Fangu												Humbje Ossh										
65,316		Fotovoltaike ne treg te lire																						
152,985		Spv Blue 1																						
21,135		H/C Qami 1																						
14,000																								
2,627																								
42.0%	0.2%	11.7%	12.9%	0.7%	2.4%	2.1%	4.1%	4.2%	1.3%	3.0%	0.4%	0.3%	0.1%	7.4%		42.5%	17.4%	7.2%	0.0%	7.6%	1.1%	4.6%	2.6%	17.7%


Për sa i përket humbjeve, duke krahasuar 6-mujoret e pare të viteve 2024 dhe 2023 rezulton se në vitin 2024 vihet re një tendencë ulje e nivelit të humbjeve ne sistemin e transmetimit si dhe atë të shpërndarjes, ku në atë te shpërndarjes rezultojnë 17.97 %.


Humbjet në sistemin e transmetimit dhe ate të shpërndarjes paraqiten ne grafiket e mëposhtem.

	JANAR	SHKURT	MARS	PRILL	MAJ	QERSHOR	6-M
Humbjet +nevoja vetiake 2024, Totale ne OST Sh.a (MWh)	22,608	17,520	17,149	17,399	16,130	13,854	104,660
Humbjet +nevoja vetiake 2023, Totale ne OST Sh.a (MWh)	25,216	17,110	19,532	18,151	22,863	16,197	119,069



	JANAR	SHKURT	MARS	PRILL	MAJ	QERSHOR
Humbjet 2024 Totale ne OSHEE Sh.a	21.28	16.8	19.37	16.67	15.94	16.06
Humbjet 2023 Totale ne OSHEE Sh.a	25.79	19.06	21.05	18.65	16.68	16.04
Targeti i Humbjeve ne Shpërndarje për vitin 2024	19	19	19	19	19	19





Siç vihet re, shkalla e hapjes së tregut gjatë 6-mujorit të parë 2024 arrin në masë 33.38 % ku tendencë progresive rritëse, ka patur edhe dalja në treg të liberalizuar e klientëve të lidhur në nivelet e tensionit 35,20,10,6 kV dhe sigurimi i humbjeve ne sistemin e transmetimit dhe atë të shperndarjes.


Disa të dhëna kryesore, janë paraqitur edhe në mënyrë krahasimore me ecurinë e të dhënave, për të cilat janë vendosur targete në Kapitullin VI “Plani i zbatimit” të VKM-në nr. 758, datë 09.12.2021 për një ndryshim në vendimin nr. 253, date 24.04.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e planit të konsolidimit financiar tësektorit publik, elektroenergjitik”.

Të dhëna më të detajuara në lidhje me bilancin energjitik për 6 mujorin e parë të vitit 2024, gjenden në Aneksin I të këtij raporti.


- Të dhëna mbi transmetimin e energjisë elektrike nga Operatori i Sistemit të Transmetimit në Shqipëri për 6-mujorin e parë vitin 2024 (MWh)

Sikurse vihet re edhe nga të dhënat e sistemit të transmetimit, (Aneks), balanca energjitike (6-m 2024) në interkoneksion, rezultojnë të larta në dhenie (1,089,087 MWh). Në 6-mujorin e parë 2023 kishim marrje nga interkoneksioni në masën (321,681 MWh). Kjo është për shkak të një situatë me të mirë meteorologjike krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar si dhe shtimit të kapaciteteve të prodhimit të energjisë nga dielli.

	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
2024	286.50	287.41	287.42	292.60	296.14	294.89						
Mesatarja	275.50	276.90	279.82	286.48	290.68	289.53	284.98	279.25	275.33	273.34	274.52	277.52
Minimumi	245.30	247.10	252.60	264.00	268.60	271.30	270.10	261.10	253.60	248.40	249.30	252.10
Maksimumi	293.16	294.10	294.40	296.90	296.90	296.20	294.30	291.50	289.40	288.30	289.20	288.00



**NIVELI I FIERZES GJATE 6-MUJORIT TE
PARE 2024 KRAHESUAR ME (Min,Maks dhe
Mesataren historike 2013-2024) (m)**



Një pasqyrë më e detajuar e të dhënave të sistemit të transmetimit të energjisë elektrike ndodhet në Aneket I, II dhe III të këtij raporti.

- **Bilanci i energjisë elektrike për OSHEE Group sh.a.**

Nga bilanci i energjisë për këtë periudhë konstatohet se:


Energjia në rrjetin e shpërndarjes rezulton në sasinë 3,589,415 MWh dhe krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2023 ka pësuar një rritje me rreth 41,490 MWh . Kjo energji është siguruar dhe ka shërbyer për mbulimin e kërkesës së klientëve të furnizuar si zbatim i detyrimit të shërbimi universal, të mundësisë së fundit dhe për mbulimin e humbjeve në sistemin e shpërndarjes.

Një pasqyrë më e detajuar e të dhënave të sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike ndodhet në Aneksin I dhe IV të këtij raporti

- **Prodhimi i energjisë elektrike**

Në tabelën e mëposhtme paraqitet në mënyrë krahasuese, prodhimi publik për 6-mujorin e parë të vitit 2024 krahasuar me atë të 6-mujorit të parë të vitit 2023.

Krahesimi i prodhimit publik për 6-mujorët e parë 2023, 2024 (MWh)							
	JANAR	SHKURT	MARS	PRILL	MAJ	Qershor	6-Mujori
Prodhimi Publik (KESH sha) 2023	665,048	599,427	350,763	318,558	488,334	381,563	2,803,692
Prodhimi Publik (KESH sha) 2024	461,940	434,525	312,293	230,865	333,613	349,424	2,122,660
<i>Diferenca</i>	<i>(203,108)</i>	<i>(164,902)</i>	<i>(38,470)</i>	<i>(87,693)</i>	<i>(154,721)</i>	<i>(32,139)</i>	<i>(681,032)</i>




Prodhimi publik i vendit, gjatë 6 mujorit të parë 2024 është rreth 681,032 MWh më i ulët krahasuar me të njëjtën periudhë 6-mujore të vitit 2023.

Trendi gjashtëmujor i vitit 2024 pavarësisht se rezulton në zbritje tregon se ky vit mund të vazhdojë të jetë mbi mesataren shumëvjeçare që është në vlerat rreth 5,5 GWh.

Gjatë 6 mujorit të parë të 2024, vihet re që kanë hyrë në operim edhe 6 centrale prodhuese të energjisë elektrike (4 nga centrale hidrike dhe 2 Fotovoltaike).

- **Niveli i Hidrocentralit të Fierzës në raport me të dhënat shumevjeçare për periudhën e 6 – mujorit të parë.**


Niveli i rezervës hidrike për këtë periudhë si rezultat i situatës hidrike rezulton që është më i lartë në krahasim me mesataren shumevjeçare të periudhave të mëparshme




Një pasqyrë më e detajuar në lidhje me këto të dhëna ndodhet në Aneksin V të këtij raporti

• STATUSI PROGRESIV I DEBITËS NDAJ OSHEE GROUP SH.A.

Duhet theksuar se nga raportimet gjendja debitoare ndaj OSHEE Group sh.a. gjatë, kësaj peridhe raportimi rezulton të ketë pasur një ulje të lehtë, në raport me periudhat e mëparshme, përveç detyrimeve të klientëve jobuxhetorë që vazhdojnë të jene te larta siç paraqitur grafikisht dhe më poshtë.





Performanca në drejtim të nivelit të humbjeve dhe arkëtimeve monitorohet në vazhdimësi nga ana e ERE-s për operatorin e shpërndarjes.

Më poshtë paraqiten rezultatet e këtyre treguesve krahasues për vitin 2024 dhe 2023.

NIVELI I HUMBJEVE (%) 2009-2024												
	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor
2009	40.75	37.05	38.05	32.93	33.44	30.75	32.60	30.20	25.34	30.67	33.44	36.89
2010	38.62	35.41	36.90	31.37	35.17	31.45	26.94	29.69	21.47	20.61	22.16	29.05
2011	55.55	38.00	36.95	23.11	24.85	21.29	21.88	19.41	22.95	25.15	32.20	35.70
2012	35.72	59.16	55.23	45.41	38.87	39.77	45.51	45.51	42.09	35.53	41.89	49.32
2013	51.12	48.71	48.29	39.66	39.52	40.33	43.33	38.50	35.08	45.98	48.08	53.04
2014	47.00	42.14	42.78	35.69	36.85	34.10	36.59	36.36	31.67	34.52	32.88	37.54
2015	36.68	31.82	32.88	30.54	31.24	28.60	30.62	29.29	25.30	29.92	30.82	34.50
2016	34.69	29.00	29.93	26.07	26.97	24.35	25.97	25.15	22.12	27.11	29.30	30.99
2017	33.50	27.63	28.66	25.81	25.88	28.31	24.69	23.29	19.79	23.76	23.55	27.90
2018	30.65	24.91	27.22	23.33	23.03	20.76	21.46	20.77	19.32	21.53	22.73	26.70
2019	29.25	23.21	26.5	21.36	22.10	19.92	20.42	19.81	17.54	20.40	21.58	24.76
2020	28.22	21.61	28.36	17.39	19.10	18.65	19.69	18.87	16.80	21.21	22.79	20.49
2021	27.87	20.1	25.92	21.08	17.92	18.34	18.75	17.93	16.22	18.56	19.88	20.25
2022	28.42	19.66	23.68	18.24	17.08	17.30	18.42	16.81	14.94	18.36	18.38	19.76
2023	25.79	19.06	21.05	18.65	16.68	16.04	17.48	16.17	14.80	17.62	18.20	21.52
2024	21.28	16.80	19.38	16.67	15.94	16.06						
Niveli i Arketimeve (%) 2009-2024												
	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor
2009	69.32	85.95	74.38	86.58	86.31	76.37	75.40	72.46	83.20	80.82	61.77	70.01
2010	55.37	66.28	86.63	89.46	86.70	79.42	74.84	124.98	84.20	70.81	56.15	66.48
2011	67.26	57.61	87.66	71.61	96.73	73.00	65.00	81.00	66.00	63.86	51.47	87.30
2012	59.80	79.20	78.50	78.00	94.70	83.50	91.60	102.90	74.00	98.00	72.60	78.00
2013	61.40	63.70	86.20	80.70	79.10	69.60	87.90	90.10	78.50	84.30	89.00	102.00
2014	84.90	77.10	85.90	85.50	81.90	80.20	86.70	83.60	102.60	101.00	101.90	141.00
2015	112.70	120.50	103.70	86.60	95.70	97.10	98.40	104.70	95.30	100.30	92.20	100.70
2016	92.10	87.00	95.60	90.10	99.10	92.00	94.20	96.70	91.50	96.70	90.30	96.70
2017	85.20	87.60	105.70	94.50	105.70	91.80	104.80	97.40	94.60	103.80	92.70	100.10
2018	96.39	95.69	105.82	98.92	111.64	100.16	105.00	102.12	93.03	108.76	96.24	108.94
2019	90.7	92.6	99.8	102.4	102.50	94.00	104.40	99.30	93.90	104.70	89.60	110.70
2020	91.4	91.6	77.5	106.8	101.80	102.20	96.80	95.30	96.60	101.10	91.50	101.80
2021	86.4	88.9	102.1	91	101.20	110.70	96.90	94.10	90.70	114.70	96.90	101.50
2022	90.6	84.3	102.7	90.5	98.00	97.90	99.90	105.00	100.60	104.50	102.30	102.90
2023	92.3	94.2	100.2	92.9	113.7	95.70	93.60	101.60	101.20	113.80	103.80	96.70
2024	92	95	101.2	104.3	110.9	96.60						
Efektiviteti i shitjeve (%) 2009-2024												
	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor
2009	41.1%	46.8%	53.6%	57.9%	50.8%	52.2%	48.8%	50.6%	62.1%	56.0%	41.1%	44.2%
2010	34.0%	56.0%	56.4%	59.5%	51.5%	51.3%	91.3%	87.9%	66.1%	56.2%	43.7%	47.2%
2011	29.9%	54.3%	45.2%	74.4%	54.9%	51.2%	63.3%	65.3%	50.9%	47.8%	34.9%	56.1%
2012	38.4%	32.1%	34.9%	51.7%	51.0%	55.2%	56.1%	56.1%	42.9%	63.2%	42.2%	39.5%
2013	30.0%	44.2%	41.7%	47.7%	42.1%	52.4%	51.1%	55.4%	51.0%	45.5%	46.2%	47.9%
2014	45.0%	49.7%	48.9%	52.7%	50.6%	57.1%	53.0%	53.2%	70.1%	66.1%	68.4%	88.1%
2015	71.4%	69.6%	60.2%	65.8%	69.3%	68.3%	72.6%	74.0%	71.2%	70.3%	63.8%	66.0%
2016	60.2%	67.0%	66.6%	72.4%	69.6%	69.7%	71.6%	72.4%	71.3%	70.5%	63.8%	66.7%
2017	56.7%	75.4%	70.1%	78.3%	65.8%	78.9%	73.4%	74.7%	75.9%	79.1%	70.9%	72.2%
2018	66.8%	77.0%	75.8%	85.9%	79.4%	82.5%	80.2%	80.9%	75.1%	85.3%	74.4%	79.9%
2019	64.2%	73.4%	80.5%	79.8%	75.3%	83.1%	79.0%	79.6%	77.4%	83.3%	70.3%	83.3%
2020	65.6%	55.5%	88.2%	82.4%	83.1%	77.7%	76.5%	77.3%	80.4%	79.7%	70.6%	80.9%
2021	62.3%	75.6%	71.8%	83.1%	90.4%	78.7%	76.5%	77.2%	76.0%	93.4%	77.6%	80.9%
2022	64.9%	78.4%	74.0%	81.3%	81.0%	81.5%	85.7%	87.3%	85.6%	85.3%	83.5%	82.6%
2023	68.5%	76.2%	79.1%	75.6%	94.7%	80.3%	77.2%	85.2%	86.2%	93.7%	84.9%	75.9%
2024	72.4%	79.0%	81.6%	86.9%	93.2%	81.1%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%

18.93
17.97

99.4
99.5


80.6
81.6%

Vërehet përmirësim i nivelit të humbjeve ne sistemin e shpërndarjes në krahasim me vitin 2023, duke arritur në nivelin e 17.98 %, gje që ben të jenë më mire se targeti prej 18.5 % për vitin 2024 dhe konstatohet qëndrueshmëri në parametrat e arkëtimeve në masën rreth 99.5% për 6-mujorin 2024 bashkë me arkëtimet e prapambetura të periudhës 2009 – 2024.

	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2022	2023	2024 (6M)
Arketimi	76.4	70.1	70.7	83.0	79.3	91.9	100.8	93.4	96.6	101.6	98.4	95.8	98.0	99.4	99.5
Humbja	34.0	30.4	37.6	46.4	45.0	37.8	31.3	28.0	26.4	23.9	21.8	21.5	19.7	18.9	17.97
Efektiviteti	50.4	48.8	44.1	44.5	43.6	57.2	69.2	67.2	71.1	77.3	77.0	75.2	78.7	80.6	81.6

	Viti 2024 (6-Mujori-I)	Viti 2023(6-Mujori-I)
Arketimi	99.50	97.8
Humbja	17.98	19.9
Efektiviteti i shitjeve	81.6	78.4

Më poshtë paraqitet ecuria e treguesit “Efektiviteti i shitjeve” i cili tregon përqindjen e energjisë së përdorur nga OSHEE Group sh.a. së cilës i është arkëtuar vlera.



Gjatë periudhës Janar-Qershor 2024, rrjeti shpërndarës ka siguruar furnizimin me energji elektrike me treguesit e cilesise se furnizimit si më poshtë, krahasuar kjo me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar rezulton një rritje e treguesve duke mundur të evidentojnë edhe vlerat e tyre për nivelet e tensionit si vijon:

Treguesit Kryesore të performancës ne furnizim 2024			
(sipas muajve dhe niveleve te tensionit)			
EMERTIMI	SAIFI	SAIDI	CAIDI
	Nr.i konsumatoreve te prekur nga nderprerjet/Nr. Kons.Gjithsej	Nr.i oreve te nderprerjeve gjithsej/Nr. Konsumatoreve Gjithsej	Nr.i oreve te nderprerjeve gjithsej /Nr. Kons. Te prekur nga nderprerjet
Total TL	0.51	1.01	2.16
Total TM	1.61	3.11	1.93
Total TU	0.13	0.12	0.96
Total OSSH Janar 2025	2.25	4.33	1.93
TL	0.35	1.05	3.00
Total TM	1.42	2.17	1.53
Total TU	0.09	0.09	1.07
Total OSSH Shkurt 2024	1.86	3.32	1.78
Total TL	0.38	0.79	2.11
Total TM	1.53	2.81	1.83
Total TU	0.12	0.13	1.07
Total OSSH Mars 2024	20.30	3.73	1.84
Total TL	0.39	0.86	2.22
Total TM	1.15	1.61	1.40
Total TU	0.10	0.09	0.93
Total OSSH Prill	1.63	2.56	1.57
Total TL	0.51	1.05	2.05
Total TM	1.58	2.56	0.12
Total TU	0.11	0.12	1.15
Total OSSH Maj	2.20	3.37	1.70
Total TL	1.43	1.84	1.28
Total TM	1.29	1.64	1.27
Total TU	0.11	0.11	0.98
Total OSSH Qershor	2.84	3.59	1.26
PROGRESIVI 6-MUJOR 2024			
	SAIFI	SAIDI	CAIDI
Total TL	3.57	6.69	1.88
Total TM	8.59	13.90	1.62
Total TU	0.65	0.67	1.03
Total OSSH 2024	12.81	21.26	1.66

Parametrat e Cilësisë Furnizimit		
3-mujori i parë 2024	Koha Mesatare e Ndërprerjes së Furnizimit me Energji Elektrike (AIT)	1.6 min
	a) Energjia e pa Furnizuar (ENS)	23.757 MWh
	b) Cilësia e frekuencës (FO)	Brenda diapazonit
	c) Periudha e Njoftimit të Ndërprerjeve të Planifikuara në Sistemin e Transmetimit	72 orë
	d) Koha e Nevojshme për t'ju Përgjigjur Kërkesave për Lidhje të Reja	23 ditë
	e) Indeksi i Kohëzgjatjes Mesatare të Ndërprerjeve (SAIDI)	7.33 min
	f) Cilësia e Tensionit (VQ) ($\pm 10\%$; 0.90 pu-1.118 pu)	Brenda
	g) Përqindja e Ankesave për Cilësinë e Tensionit.	Nuk ka
3-mujori i dytë 2024	Koha Mesatare e Ndërprerjes së Furnizimit me Energji Elektrike (AIT)	6.12 min
	a) Energjia e pa Furnizuar (ENS)	75.434 MWh
	b) Cilësia e frekuencës (FO)	Brenda diapazonit
	c) Periudha e Njoftimit të Ndërprerjeve të Planifikuara në Sistemin e Transmetimit	72 orë
	d) Koha e Nevojshme për t'ju Përgjigjur Kërkesave për Lidhje të Reja	22 ditë
	e) Indeksi i Kohëzgjatjes Mesatare të Ndërprerjeve (SAIDI)	18.19 min
	f) Cilësia e Tensionit (VQ) ($\pm 10\%$; 0.90 pu-1.118 pu)	Brenda
	g) Përqindja e Ankesave për Cilësinë e Tensionit.	Nuk ka

Këto tregues merren në shqyrtim të ndarë sipas zonave urbane dhe rurale. Referuar treguesve të performancës së Sistemit të Shpërndarjes, konstatohet se rrjeti i shpërndarjes për këtë periudhë llogarit edhe treguesit në tension të ulët dhe në total reflektohet tendencë përmirësimi. Duke analizuar parametrat e përcjella nga OSSH sh.a. për 6-mujorin e parë të vitit 2024, vërejmë që këto parametra janë konform standardeve të përcaktuara nga ERE me anë të vendimit nr. 97/2021, por është ende herët për të krahasuar apo analizuar gjerësisht parametrat sepse janë të disponueshëm vetëm gjashtë muaj. Këto tregues raportohen si vijon: SAIDI konkretisht 21.26 min. Krahasuar me një vit më parë, 6 mujorin e parë të vitit 2023 kjo vlerë është përmirësuar duke marrë parasysh së për 6 mujorin e parë të 2023 ky tregues është raportuar 21.68 min. Vlera e SAIFI për 6-mujorin e parë të vitit 2024 rezulton 12.81 min, duke e krahasuar me po të njëjtën periudhë të vitin të kaluar, ky index ka pësuar një rritje të lehtë me atë të raportuar për 6 mujorin e parë të vitit 2023, 12.39 min.

Sa i përket parametrave të cilësisë së furnizimit lidhur me energjinë e pa furnizuar, vlera këtë periudhën është 25,781 MWh, ndërsa ajo e parashikuar në vendimin nr. 97/2021 shënon 51,246 MWh.

Duke ju përmbajtur vlerave të raportuara nga ana e OSSH sh.a. për standardet, nga vlerësimet e deritanishme theksojmë se kompania është duke performuar brenda pritshmërive dhe nuk shihet vështirësi për arritjen e treguesve të cilësisë që burojnë nga vendimi nr. 97/2021 i miratuar nga ERE.

- **Mmonitorimi i shit-blerjeve të energjisë elektrike në treg të liberalizuar nga shoqëria e ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik KESH sh.a**

- Gjatë 6 mujorit të parë të vitit 2024 ERE ka monitoruar përmes raportimit periodik shit-blerjet e energjisë elektrike në treg të hapur nga shoqëritë pjesërisht të rregulluar KESH sh.a., ku rezulton se çmimi mesatar i ponderuar i blerjes së energjisë në treg të hapur nga shoqëria KESH sh.a., e ngarkuara me detyrimin e shërbimit publik është rreth 84.3 EUR/MWh, ndërkohë që çmimi mesatar i ponderuar i shitjes së energjisë në treg të hapur nga shoqëria KESH sh.a. rezulton me rreth 75.6 EUR/MWh.
- KESH sh.a. edhe përgjatë 6 mujorit të parë të vitit 2024 ka shitur/blerë dhe shkëmbyer energji elektrike në treg të parregulluar kryesisht për optimizim, në zbatim të “Rregullores së Tregtimit të Energjisë Elektrike nga Korporata Elektroenergjitike Shqiptare KESH sh.a.” miratuar me Vendimin nr. 2762/8, datë 06.06.2019, të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, në rolin e pronarit të KESH sh.a. dhe “Rregullave të përgjithshme të organizimit të aktivitetit tregtar nga Korporata Elektroenergjitike Shqiptare sh.a.” të miratuar me Vendimin nr.5233/1, datë 12.06.2020, të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionerit.

Një pasqyrë më e detajuar në lidhje me këto të dhëna ndodhet në Aneksin VII të këtij raporti

•Rregullorja për Integritetin dhe Transparencën e Tregut me Shumicë të Energjisë (REMIT)

Me vendimin e ERE nr. 126, datë 17.05.2021, është miratuar Rregullorja për Integritetin dhe Transparencën e Tregut me Shumicë të Energjisë (REMIT). Rregullorja për Integritetin dhe Transparencën e Tregut me Shumicë të Energjisë transponon Rregulloren REMIT 1227/2011 siç është miratuar dhe përshtatur për Palët Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë dhe ka si qëllim të përcaktojë kriteret që ndalojnë praktikën abuzive që mund të ndodhin dhe prekin tregjet e energjisë me shumicë. Në të njëjtën kohë Rregullorja ndihmon në funksionimin e duhur të këtyre tregjeve, duke marrë parasysh karakteristikat e tyre specifike.

- Detyrime që lindin nga Rregullorja për Integritetin dhe Transparencën e Tregut me Shumicë të Energjisë (REMIT)

Rregullorja për Integritetin dhe Transparencën e Tregut me Shumicë të Energjisë, ndalon tregtimin e energjisë nga personat e brendshëm të kompanive. Kjo për faktin se këta persona posedojnë informacione të brendshme në lidhje me produktet e energjisë që do të tregtohet për rrjedhojë përfshirja e këtyre personave në procesin e tregtimit të produkteve të energjisë dëmton konkurrencën, transparencën dhe deformon tregun e energjisë.

- Monitorimi dhe regjistrimi i pjesëmarrësve në treg në zbatim të rregullorës REMIT

ERE monitoron aktivitetin tregtar të produkteve të energjisë me shumicë për të zbuluar dhe parandaluar tregtinë bazuar në rrjedhjen e informacionit të brendshëm dhe manipulimin e tregut vendas. ERE bashkëpunon në nivel rajonal nëpërmjet Bordit Rregullator të Komunitetit të Energjisë në kryerjen e monitorimit të tregjeve të energjisë me shumicë. Për monitorim të tregut të energjisë me shumicë, ERE gjithashtu bashkëpunon me Autoritetin e Konkurrencës, apo ndonjë organ tjetër për këtë qëllim. Në kryerjen e monitorimit të tregut, Autoriteti i Konkurrencës ose organi i monitorimit të tregut do të kenë të njëjtat të drejta dhe detyrime si ERE.

Pjesëmarrësit e tregut që hyjnë në transaksione me produkte të energjisë me shumicë në Shqipëri, ose shprehin interesin për të hyrë në transaksione të tilla përmes procedurave të tregtimit, duhet të regjistrohen pranë ERE.

- Regjistrimi i pjesëmarrësve të tregut sipas REMIT

Edhe përgjatë 6 mujorit të parë të vitit 2024 ERE në zbatim të rregullores REMIT, ka vijuar përditësimin dhe përmirësimin e një rubrike të vecantë në faqen zyrtare të internetit në seksionin, Tregu i Energjisë. Në këtë rubrikë gjenden dokumentat përkatës të rregullores përfshi dhe shtojcën A në të cilën paraqiten respektivisht Forma 1, kjo formë do të përdoret për paraqitjen e Informacionit nga ERE në Bordin Rregullator të Komunitetit të Energjisë (ECRB) në rast të dyshimeve për ndikime abuzive në Palët Kontraktuese bazuar në nenin 4(1) të ECRB, akti procedural 01/2020, si dhe Forma 5 e cila do të përdoret me qëllim krijimin e Regjistrimit Kombëtar të pjesëmarrësve të tregut i cili publikohet dhe përditësohet periodikisht.

Edhe përgjatë 6 mujorit të parë të vitit 2024, fokusi kryesor i punës së ERE këtë vit ka qënë në mirëmbajtjen dhe azhurnimin Regjistrimit Kombëtar REMIT në Shqipëri, i publikuar në faqen e ERE.

Regjistri REMIT i pjesëmarrësve të tregut i përditësuar deri 30.06.2024, qendet në Aneksin VI të këtij raporti

- **Monitorimi i zbatimit të detyrimeve sa i takon sigurisë kibernetike për 6 mujorin e parë të vitit 2024.**

Rregullorja për Sigurinë Kibernetike të Infrastrukturave Kritike në Sektorin e Energjisë Elektrike e miratuar me Vendimin Nr, 126 datë 30.07.2020 nga Bordi i ERE-s, përcakton rregullat dhe masat që duhet të ndërmerren nga subjektet e licensuara në sektorin e energjisë elektrike të cilët kanë përgjegjësi të garantojnë sigurinë kibernetike në infrastrukturat kritike që zotërojnë dhe operojnë, në funksion të sigurimit të furnizimit të pandërprerë me energji elektrike të konsumatorëve. Neni 6 i kësaj rregulloreje përcakton detyrimin nga subjektet e ngarkuara për zbatimin e kësaj rregulloreje për raportim periodik një herë në 6 muaj, për çështje që i përkasin sigurisë kibernetike. Sa i përket monitorimit nga ERE për zbatimin e këtij detyrimi për 6 mujorin e parë të vitit 2024. vërehet: Edhe përgjatë 6 mujorit të parë të vitit 2024 nuk u raportua të ketë pasur sulme të ndodhura në sistemet e kompanive të sektorit elektroenergjitik.

OST sh.a. është kompania e parë në sektorin energjitik në Shqipëri e certifikuar me standardin ISO 27001 (03.08 2021).

OST sha ne raportin per 6-mujorin e pare 2024 mbi zbatimin e rregullores per sigurine kibernetike ne formë te permblledhur paraqet si vijon:

Në kontekstin e një shtate të kërcënimit kibernetik në zhvillim të shpejtë, edhe për 6-mujorin e parë të vitit 2024 siguria kibernetike ka qenë prioritet për OST sh.a. si nga pikëpamja operationale ashtu dhe projektet dhe zhvillimet e sistemeve dhe platformave për të garantuar disponueshmërinë dhe integritetin e sistemeve, ne zbatim të rekomandimeve të AKCESK dhe standarteve dhe praktikave më të mira. Projektet dhe objektivat të cilat kanë përfunduar gjate kesaj periudhe apo janë në zhvillim, renditen në vijim:

- a) Projekti për rritjen e sigurisë në rrjetin e OST sh.a., OT Asset and Threat Management, me mbështetjen financiare dhe teknike të USAID. Projekti filloi fazën e implementimit gjatë muajit shkurt dhe përfundoi në fund të muajit Maj.
- b) Zgjerimi i sistemit AV i cili ka të bëjë me implementimin e një infrastrukture të zgjeruar të Detektimit dhe Përgjigjes (XDR) dhe të Parandalimit dhe Përgjigjes së Zgjeruar (XPR). Ky projekt ka përfundur fazën e implementimit dhe optimizimit të zgjidhjes dhe është operacional.
- c) Projekti i Sistemit të backup të të dhënave i cili mundeson krijimin e kushteve e standarteve "Business continuity". Ky projekt është pjesë e projektit të upgrade të sistemit SCADA i cili përfundoi në 2023.
- d) Upgrade dhe zhvillimi i sistemit mbrojtës për Sistemin e matjes Online i cili konsiderohet si një nga sistemet kryesore dhe kritike në OST sh.a.
- e) Implementimi i upgrade, zgjerimit të sistemit backup dhe zgjerimit të platformave qendrore TI që do të garantojnë jo vetëm ruajtjen e të dhënave por edhe sigurimin e integritetit dhe besueshmërisë të tyre për sa i përket sulmeve keqdashese të tipeve ransomware, pra krijimin e kushteve të standarteve "Business continuity"
- f) Ngritja dhe integrimi i teknologjive ZTNA (Zero Trust Network Access) dhe PAM (Privileged Access Management), MFA dhe teknika për mbrojtjen e sistemeve dhe qasjen e sigurtë, sipas rekomandimeve të AKCESK dhe praktikave më të mira.
- g) Rinovim dhe Auditim vjetor i Certifikatës ISO27001 sipas grafikut vjetor për OST në standardin e sigurisë ISO 27001 :2022 (standart i ri). Nuk informohet se në c'fazë është

procesi i rinovimit te kesaj certifikate pasi ne date 02.08.2024 perfundon afati tre vjecar i certifikimit aktual me këtë standart.

- h) Trajnimi i vazhdueshëm i të gjithë stafit mbi sigurinë kibernetike.

Sa i takon analizes se raportit te vetevleresimit per 6-Mujorin e pare te vitit 2024 u konstatua se nga 169 dokumente qe permban formulari:

13 dokumente mungojne

5 dokumente jane te pazbatueshme (NA)

4 dokumente raportohen te kryera (PO) por nderkohe, ne kollonen e shenimeve te formularit, sqarohet prej shoqerise se keto dokumente ose jane ne proces rishikimi ose duhet te behet perditësimi (update) i tyre.

Per sa me lart, rezulton se OST ka plotesuar 87% te dokumentave te formatit te vetevleresimit. Per kete periudhe konstatohet nje ulje e lehte e nivelit te plotesimit te dokumentacionit te nevojshem te percaktuar ne Rregullore krahasuar me 92% qe rezultoi ne pjesen e dyte te vitit 2023. Per t'u permendur eshte fakti se OST sh.a. ka deshmuar vazhdimisht korrektese dhe permiresim ne drejtim te raportimit per sigurine kibernetike.

ERE ka sjellë në vëmendje të OST sha detyrimin për përmirësimin e sa më sipër dhe është nën mbikqyrje të vazhdueshme.

OSHEE Group sh.a përgjatë 6 mujorit të parë të vitit 2024 raporton se lufta kundër krimit kibernetik dhe siguri i një ambienti TIK të mbrojtur është nje ndër prioritet e saj ne arritjen e objektivit për sigurimin e operimit të sigurt, të besueshëm, në pajtueshmëri dhe pandërprerje.

Gjatë periudhës janar 2024 — qershor 2024 nuk ka pasur incidente kibernetike.

- a) Për rritjen e efikasitetit të sigurisë kibernetike të OSHEE GROUP SH.A. ka përfunduar segmentimin e mëtejshëm të rrjetit të brendshëm dhe kryer segmentimin e serverave në VLAN-e të ndryshme. Vendosur në VLAN-et përkatëse të serverave të aplikacioneve dhe serverave të bazave të të dhënave;
- b) Ka kryer implementimin e ISE AAA për një pjesë të konsiderueshme përdoruesish në HQ dhe vijon implementimi për pjesën e mbetur;
- c) Ka kryer përditësimin e Firewall të brendshëm, VPN, EDR, WAF dhe Mail Gateway në versione më të sigurta;
- d) Ka kryer bllokimin e IP-ve, hashe-ve dhe url-ve keqdashëse në Firewall të jashtëm, EDR dhe Mail.
- e) Ka kryer kalimin e pjeses më të madhe te drejtorive rajonale në teknologjinë DMVPN. Vazhdohet puna per pjesën e mbetur;
- f) Kryer implementimin me sukses të Adaptive Protection, i cili detekton dhe paralajmeron aktivitet jo normale ne rrjet;
- g) Kryer implementimin me sukses të GPO-ve të ndryshme për rritjen e sigurisë në infrastrukturë;
- h) Janë në proces mplementimi: Business Continuity, Disaster Recovery, Cyber Recovery dhe IAM;

Sa i takon formatit të raportit të vetevleresimit për 6-Mujorin e parë të vitit 2024, megjithëse rezultojnë se është bërë përpjekje serioze për hartimin e dokumentacionit të kërkuar në formularin e raportit të vetevleresimit, raportimi i OSHEE Group sh.a. për nga forma dhe përmbajtja ka konfuzion në mënyrën e hartimit dhe detajimit të tij, që do të kërkojë vijimin e bashkëpunimit dhe mbikqyrjes së vazhdueshme me qëllim përmbushjen e detyrimeve jo vetëm në afat por edhe sipas kriterëve të procedurave të parashikuara.

Evidentojmë se, në komunikimet e mëparshme OSHEE Group sh.a. informonte se kishte planifikuar që në buxhetin për vitin 2022 përfshirjen e projektit të sigurisë kibernetike për infrastrukturën IT dhe certifikimit për standartin e sigurisë ISO 27001, gjithashtu, në këto komunikime shoqëria informonte se ishte në komunikim me Autoritetin Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike si dhe po përmirësonte procedurat për standartet e sigurisë kibernetike.

Verehet se në raportimin e fundit shoqëria nuk ka paraqitur informacion në lidhje me ecurinë e procesit të certifikimit me standartin ISO 27001 i cili është një detyrim i përcaktuar në nenin 10 të Rregullores për Sigurinë Kibernetike.

Në kuader të forcimit dhe mbajtjes së standarteve të sigurisë kibernetike për vetë rregullatorin, ERE ka zhvilluar procedurën me objekt “Përmirësimi i mbrojtjes dhe sigurisë së rrjetit të ERE dhe implementimi i firewall” dhe ka finalizuar kontratën me operatorin ekonomik fitues.

Përgjatë kësaj periudhe vlen për tu theksuar miratimi i marrëveshjes për bashkëpunim midis Autoritetit Kombëtar për Sigurinë Kibernetike (AKSK) dhe Entit Rregullator të Energjisë (ERE), që do të të rrisë ndjeshëm rëndësinë dhe fokusin në drejtim të Sigurisë Kibernetike në sektorin e energjisë dhe praktikën që lidhen me të.

- **BURSA SHQIPTARE E ENERGJISË ELEKTRIKE (ALPEX sha)**

- **Operimi i Bursës Shqiptare të Energjisë**

ALPEX sh.a operon bazuar në Vendimin e Bordit të ERE Nr. 347, datë 27.12.2022 “Për miratimin e Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike (Rregullat e ALPEX – Kushtet e Përgjithshme, Përkufizimet, Procedura e Tregtimit si dhe Procedura e Klerimit dhe Shlyerjes)”, si dhe Vendimin e Bordit të ERE Nr. 106, datë 23.03.2023 “Mbi miratimin e disa shtesave në Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike, të miratuara me Vendimin e Bordit të ERE Nr. 347, datë 27.12.2022”.

Në të njëjtën kohe bazuar në Vendimin e Bordit të ERE Nr. 127, datë 07.04.2023 “Për miratimin e Njesisë Kohore të Tregut” operimi i bursës shqiptare të energjisë ka filluar në orën 00:00 të datës 12.04.2023.

- **Anëtarësimi në Bursë zona e ofertimit Shqipëri**

A. Numri i anëtarëve të bursës të regjistruar është - 18 (tetëmbëdhjetë)

1. Operatori i Sistemit të Transmetimit – OST sh.a
2. Furnizuesi i Tregut të Lirë – FTL sh.a
3. Furnizuesi i Shërbimit Universal – FSHU sh.a
4. Korporata Elektroenergjitike Shqiptare – KESH sh.a
5. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes – OSSH sh.a
6. Ener Trade sh.p.k
7. EZ-5 Energy sh.p.k
8. GEN-I TIRANA sh.p.k
9. ReNRGY Trading Group sh.p.k
10. Future Energy Trading and Exchange Dynamics sh.p.k – Dega në Tiranë
11. Natyre Energy sh.p.k
12. NOA sh.p.k
13. Danske Commodities Albania sh.p.k
14. GSA sh.p.k
15. Energy Financing Team Tirana sh.p.k
16. Devoll Hydropower sh.p.k
17. Dragobia Energy sh.p.k
18. SPV BLUE 1 sh.p.k

B. Anëtar i Përgjithshëm i Klerimit

1. Raiffeisen Bank Albania
2. Tirana Bank

- Anëtarësimi në Bursë zona ofertimit Kosovë

Numri i anëtarëve të bursës të regjistruar është - 7 (shtatë)

1. Operatori i Sistemit të Transmisionit dhe Tregut – KOSTT sh.a
2. Korporata energjetike e Kosovës – KEK sh.a
3. Ndërmarrjes Hidroekonomike “Ibër-Lepenc” sh.a
4. Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike – KESCO sh.a
5. Future Energy Trading and Exchange Dynamics sh.p.k – Kosovo
6. Enerco sh.p.k
7. GSA ENERGIJI sh.p.k

A. Anëtar i Përgjithshëm i Klerimit

1. ProCredit Bank Kosovë
2. BKT Kosovë


- Operimi i tregtimit

Gjatë vitit 2024, ALPEX-i ka vënë në përdorim për anëtarët e Bursës platformën e tregtimit ETSS dhe për anëtarët e përgjithshëm të klerimit platformën EMCS. Këto platforma kanë qenë të aksesueshme gjatë gjithë kohës për përdoruesit përkatës dhe kanë performuar pa çënuar funksionimin normalisht të aktivitetit. Tregtimi dhe klerimi është kryer çdo ditë sipas kalendarit përkatës.


ALPEX pas miratimit me vendimin e Bordit të ERE-s, aplikon ankandin e dytë me qëllim ruajtjen e tregut nga çmimet që konsiderohen të gabuara ose të paqëndrueshme, këto në referencë me Kufirin Minimal të çmimit 0 (zero) euro/MWh dhe Kufirin Maksimal të Lejuar të Çmimit për Tregun e Ditës në Avancë çmimin 900 euro/MWh.

Ankandi i dytë është aktivizuar për 7 (shtatë) Ditë Livrimi vetëm gjatë muajit Qershor 2024.


Për zonën e ofertimit të Shqipërisë, oferta në blerje javë e fundit ishte 19,925 MWh krahasur me 20,991 MWh të një jave më përpara, ndërkohë oferta në shitje ka qenë 8,951 MWh / 19,137 MWh (grafiku më poshtë).



Për bashkimin e tregut të Shqipërisë-Kosovës, oferta në blerje rezulton 26,541 MWh krahasur me 26,897 MWh të një jave më përpara, ndërkohë oferta në shitje ka qënë 27,941 MWh / 34,213 MWh. Oferta në shitje si për tregun e Shqipërisë ashtu edhe atë të bashkimit të tregut është shumë e lartë se ajo e blerjes, gjë që ka sjellë plotësimin e nevojave dhe në shumë rast çmime më të ulta se vendet e rajonit.



Me fillimin e Bashkimit të Tregut është parë një rritje e anëtarëve të bursës, aktivë në procesin e tregtimit që luhatet midis 15-16 pjesmarrës në të dy tregjet. Pozicioni i tregut të Shqipërisë javën e fundit në këtë bashkim tregu ka qënë pothuajse importues me total volume 5,801 MWh kundrejt 110 MWh si eksportues.



- Klerimi dhe shlyerja

Aktiviteti i klerimit dhe transaksionet e shlyerjes kryhen në mënyrë periodike sipas kalendarit përkatës nëpërmjet anëtarëve të përgjithshme të klerimit dhe bankës për shlyerje (RBAL), ku sipas ALPEX sha, vlera mesatare ditore e faturimit të energjisë elektrike për muajin qershor 2024 (blerje-shitje) është mesatarisht në vlerën € 388,276.


- Të dhënat e tregtimit dhe klerimit


Të dhënat e Tregut të Ditës në Avancë				
Progresive 2024	Min Ditor	Max Ditor	Mesatare Ditore	Total
Volumi në MWh	705	3,293	2,508	456,477
Çmimi (€/MWh)	-€ 500.00	€ 4,000	€ 79.38	-

Faturimet (blerje-shitje)				
Periudha	Min Ditor	Max Ditor	Mesatare Ditore	Total
VITI 2023	€ 298,267	€ 1,189,196	€ 635,238	€ 167,702,808
Janar 2024	€ 227,734	€ 653,022	€ 457,618	€ 14,186,161
Shkurt 2024	€ 291,992	€ 576,630	€ 422,685	€ 12,257,875


Mars 2024	€ 178,523	€ 628,547	€ 382,096	€ 11,844,977
Prill 2024	€ 106,672	€ 448,910	€ 298,814	€ 8,964,411
Maj 2024	€ 127,129	€ 593,407	€ 379,854	€ 11,775,472
Qershor 2024	€ 238,616	€ 1,595,220	€ 477,114	€ 14,313,414
Akumulative 2024	€ 106,672	€ 1,595,220	€ 402,980	€ 73,342,309


Volumet e tregtuar në MWh				
Periudha	Min Ditor	Max Ditor	Mesatare Ditore	Total
VITI 2023	2,029	4,450	3,135	827,546
Janar 2024	1,919	2,651	2,390	74,100
Shkurt 2024	2,166	3,093	2,771	80,345
Mars 2024	1,909	3,029	2,651	82,194
Prill 2024	2,151	2,788	2,469	74,071
Maj 2024	705	3,293	2,505	77,647
Qershor 2024	1,527	2,824	2,271	68,120
Akumulative 2024	705	3,293	2,508	456,477






Volumet ditore mesatare të tregtuara në ALPEX për vitin 2024 jepen në grafikun e mëposhtëm





1. ALPEX raporton se ka kryer analizën midis çmimeve mesatare të tij me ato të **HUPX** për të gjetur korrelacionin midis tyre. Nga të dhënat rezulton se, në 73.1 % të rasteve, çmimet ndjekin të njëjtin trend (rritës ose zbritës) ndërkohë çmimi mestar në HUPX, rezulton më i ulët në 65.4% të rasteve ndërsa në ALPEX në 34.6% të rasteve ose 5.01 Euro mesatarisht më i lartë në ditë.
2. ALPEX raporton se ka kryer analizën midis çmimeve mesatare të tij me ato të **HENEX** për të gjetur korrelacionin midis tyre. Nga të dhënat rezulton se në 67.6 % të rasteve, çmimet ndjekin të njëjtin trend (rritës ose zbritës) ndërkohë çmimi mestare në HENEX rezulton më i ulët në 45.6% të rasteve ndërsa në ALPEX në 54.4% të rasteve ose 0.34 Euro mesatarisht më i ulët në ditë.



- Rekomandime për operatorët dhe pjesëmarrësit e tregut nga monitorimet

Në kuadër të vijimit të ushtrimit të funksionit monitorues nga ERE edhe përgjatë 6 mujorit të parë të vitit 2024 , për operatorët dhe pjesëmarrësit e tregut janë lënë rekomandime dhe detyra si vijon:

- Zbatimi i plotë i Rregullave për publikimin e të dhënave bazë të Tregut të Energjisë Elektrike, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 118, datë 27.07.2017, nga OST sh.a. dhe shoqëritë të cilat janë pjesë e OSHEE Group sh.a. në kuadër të rritjes së shkallës së transparencës në tregun e energjisë elektrike;
- Zbatimin me rigorozitet të përcaktimeve të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 106, datë, 02.07.2020 “Mbi miratimin e rregullave të tregut Shqiptar të balancimit të energjisë elektrike”, nga OST sh.a. përfshirë dhe garantimin e neutralitetit të saj financiar siç është përcaktuar në këto rregulla;
- Zbatimin e kriterëve të plota të ndarjes së OSHEE Group sh.a. në tre kompanitë e licencuara OSSH sh.a., FSHU sh.a. dhe FTL sh.a., përfshirë dhe format e mënyrat e raportimit të të dhënave në ERE sipas ndarjes;
- Marrjen e masave nga OST sh.a., OSHEE GROUP sh.a. dhe KESH sh.a. për zbatimin e plotë të parashikimeve të Rregullores për Sigurinë Kibernetike të Infrastrukturave Kritike në Sektorin e Energjisë Elektrike me vendimin e Bordit të ERE-s Nr. 126 datë 30.07.2020.

ANEXE

Aneksi I - Bilanci elektroenergjitik 6-mujori i pare 2024 (MWh)

BILANCI ENERGJITIK 2024 (MWh) (6M-I 2024)																																
Prodhimi neto publik		Prodhuar nga PPE në rrjetin e OSSH			Prodhuar nga PPE në rrjetin e OST		Prodhues të pavarur							Prodhim neto vendas																		
Prodhimi Neto KESH sha		HEC Selitë	HEC.Priv/Kon në Rrjetin e OSSH për FTL	Fotovoltaik (kont FTL)	HC.Priv/Kon në Rrjetin e OST për FTL	HEC Ashta	HEC Banja	HEC Moglica	HEC KURUM	HEC Peshqesh	HEC Fangu	HEC Qami	SPV Blue 1		Fotovoltaik (në treg të lirë)																	
2,122,660		10,458	591,893	33,805	652,685	121,628	108,386	208,656	212,543	65,316	152,985	2,627	14,000		21,135																	
Blerje KESH në treg të liberalizuar		95,772																														
Prodhim+Blerje		2,218,432																														
Shkembime (hyrje) KEK		360,193																														
Shkembime (dalje) KEK																																
Energji shërbime ndihmëse+ disbal																																
Energji për FSHU nga KESH sha		1,858,239																														
Energji nga KESH për FSHU 1,858,239 Energji nga FTL për FSHU 801,010 2,659,249 Energji për FSHU Klient të Shërbimit Universal														Ballanca në interkoneksion (dhenie)																		
Energji e siguruar nga FTL <table><tr><td>Blerje Neto (Selitë)</td><td>Blerje HC.Priv/Kon në Rrjetin e OSSH për FTL</td><td>Blerje FOTOVO LTAIK</td><td>Blerje HC.Priv/Kon në Rrjetin e OST për FTL</td><td>Blerje Neto Ashta</td><td>Blerje në Treg të Liberalizuar nga FTL</td></tr><tr><td>10,458</td><td>591,893</td><td>33,805</td><td>652,685</td><td>121,628</td><td>272,819</td></tr><tr><td colspan="6">1,683,288</td></tr></table>															Blerje Neto (Selitë)	Blerje HC.Priv/Kon në Rrjetin e OSSH për FTL	Blerje FOTOVO LTAIK	Blerje HC.Priv/Kon në Rrjetin e OST për FTL	Blerje Neto Ashta	Blerje në Treg të Liberalizuar nga FTL	10,458	591,893	33,805	652,685	121,628	272,819	1,683,288					
Blerje Neto (Selitë)	Blerje HC.Priv/Kon në Rrjetin e OSSH për FTL	Blerje FOTOVO LTAIK	Blerje HC.Priv/Kon në Rrjetin e OST për FTL	Blerje Neto Ashta	Blerje në Treg të Liberalizuar nga FTL																											
10,458	591,893	33,805	652,685	121,628	272,819																											
1,683,288																																
